

20152256270

L I G J
PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN NGROHTORJA E MANASTIRIT, QË
DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS KREDITORE PËR RINDËRTIM KFV DHE
SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton pagimin e obligimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes për hua për financimin e projektit Ngrohtorja e Manastirit, që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim KFV dhe SHA ELEM në shumë prej 39.000.000 euro, në afate dhe kushte të parapara me Marrëveshjes për hua, nëse SHA ELEM nuk i plotëson dhe servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua që do të lidhet ndërmjet Bankës Kreditore për Rindërtim KFV dhe SHA ELEM për financimin e projektit Ngrohtorja e Manastirit.

Neni 3

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji.

Neni 4

Afati për pagimin e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është shkallë e kamatës fikse dhe e njëjta do të përcaktohet në mënyrë plotësuese në ditën e nënshkrimit të marrëveshjeve.

Huaja do të paguhet në këste gjysmëmujore që arrijnë për pagesë më 30 janar dhe 30 korrik.

SHA ELEM do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim KFV provizion të njëhershëm në shumë prej 1% të shumës së huas.

SHA ELEM do t'i paguajë Bankës Kreditore për Rindërtim KFV provizion në shumë prej 0,25% nga pjesa e patërhequr e huas në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.